

VENDIM
Nr. 220, datë 11.3.2015

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR PAJISJEN ME
EKOETIKETË, MËNYRËN E PËRDORIMIT DHE VLEFISHMËRINË E SAJ, DHE
PËRBËRJEN E FUNKSIONIMIT E KOMISIONIT PËR LËSHIMIN E
EKOETIKETËS¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Produktet me ndikim negativ të reduktuar mjedisor gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor pajisen me ekoetiketë, sipas procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Qëllimi i dhënies së ekoetiketës është promovimi i produkteve me ndikim më të reduktuar në mjedis, krahasuar me produkte të tjera ekuivalente, duke kontribuar, kështu, në përdorimin efikas të burimeve natyrore, për një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit si dhe informimin e konsumatorëve për produkte të tilla.

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ndërsa termat e mëposhtme kanë kuptimet, si më poshtë vijon:

a) “Grup produkti” nënkupton një grup produktesh të ngjashme në karakteristikat funksionale dhe kushtet e përdorimit ose që shërbejnë për qëllime të ngjashme dhe janë të ngjashme në kushtet e perceptimit nga ana e konsumatorit;

b) “Komisioni Shtetëror për Dhënien e Ekoetiketës”, më poshtë Komisioni, është organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave për pajisjen me ekoetiketë;

c) “Ndikim mjedisor” nënkupton çdo ndryshim ndaj mjedisit që vjen plotësisht ose pjesërisht si rezultat i një produkti gjatë ciklit të jetës së tij;

ç) “Operator” nënkupton çdo prodhues, fabrikues, importues, ofrues shërbimi, shitës me shumicë ose me pakicë;

d) “Performancë mjedisore” nënkupton rezultatin e menaxhimit, nga ana e prodhuesit, të karakteristikave të një produkti që ka ndikim në mjedis;

dh) “Produkt” nënkupton çdo mall që prodhohet, shpërndahet për konsum ose përdorim si dhe çdo shërbim që ofrohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) “Verifikim” nënkupton procedure e vlerësimit nëse një produkt përmbush ose jo kriteret e specifikuar në këtë vendim për pajisjen me ekoetiketë.

4. Ekoetiketa jepet për produkte dhe grupin e produkteve të listuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ekoetiketa nuk jepet për:

a) produkte që përmbajnë substanca e preparate të klasifikuara si shumë toksike, toksike dhe të rrezikshme për mjedisin, për riprodhimin ose mutagjene, kancerogjene, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

¹ Ky vendim transponon pjesërisht rregulloren nr. 66/2010 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2009 për ekoetiketën BE, EUR-Lex - 2010R0066 – EN, Fletorja Zyrtare OJ L 27, 30.01.2010, p.1

b) mallrat e prodhuara nga procese që dëmtojnë, mund të dëmtojnë ose mund të jenë të dëmshme, në mënyrë të konsiderueshme, për njeriun dhe/ose mjedisin.

II.KRITERET

1. Kriteret për dhënien e ekoetiketës përfshijnë kërkesa për të siguruar që produktet që do të mbajnë ekoetiketën do të funksionojnë në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre, sipas standardeve të miratuara me legjislacion të posaçëm.

2. Kriteret për dhënien e ekoetiketës bazohen në performancën mjedisore të produkteve, duke marrë në konsideratë objektivat më të fundit strategjike në fushën e mjedisit. Këto kriterë përcaktojnë kërkesat mjedisore që duhet të përmbushë një produkt për të mbajtur ekoetiketën.

3. Kriteret për dhënien e ekoetiketës bazohen në të dhëna shkencore, duke marrë në konsideratë gjithë ciklin e jetës së produktit. Në përcaktimin e këtyre kriterëve duhet të merren në konsideratë, si më poshtë vijon:

a) ndikimet më domethënëse mjedisore, në veçanti ato për ndryshimin e klimës, ndikimin në natyrë dhe biodiversitet, konsumi i energjisë dhe burimeve, gjenerimi i mbetjeve, emetimet në përbërësit natyrorë të mjedisit, ndotja, perms efekteve fizike, dhe përdorimi e çlirimi i substancave të rrezikshme;

b) zëvendësimi i substancave të rrezikshme me substanca më të sigurta ose nëpërmjet përdorimit të materialeve apo projekteve alternative, kur është teknikisht e realizueshme;

c) potenciali për të reduktuar ndikimet mjedisore negative, lidhur me qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë ose ripërdorimin e produktit;

ç) balancën mjedisore neto, midis përfitimeve dhe humbjeve, në kontekstin mjedisor, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë në faza të ndryshme të jetëgjatësisë së produktit;

d) ndikimi social dhe etik, referuar konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, që kanë lidhje me to, siç janë standardet përkatëse të Organizatës Botërore të Punës (ILO) dhe kodet e sjelljes;

dh) kriteret e përcaktuara për etiketa të tjera mjedisore ISO, të miratuara në nivel kombëtar apo rajonal, kur ato ekzistojnë, për atë produkt apo grup produkti;

e) parimi i reduktimit të testimit të kafshët.

4. Kriteret për dhënien e ekoetiketës për çdo produkt dhe grup produkti, të listuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratohen me udhëzime të përbashkëta të ministrit përgjegjës për mjedisin, ministrit përgjegjës për shën-detësinë, ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ministrit përgjegjës për turizmin, sipas fushave të veprimtarisë.

III. DHËNIA E EKOETIKETËS, TER-MAT DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË SAJ

1. Operatori, që kërkon të pajisë produktin me ekoetiketë, depoziton kërkesën e tij në ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

2. Kërkesa, me shkrim, për pajisje me ekoetiketë, shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) të dhënat personale të operatorit, adresa, kontaktet;

b) emërtimin e produktit, për të cilin kërkohet ekoetiketa;

c) studimin për harmonizimin e produktit me kriteret e miratuara;

ç) mandatpagesën për tarifën.

3. Studimi për harmonizimin e produktit duhet të specifikojë të dhënat e plota dhe përshkrimin e detajuar për produktin apo grupin e produktit si dhe të gjitha informacionet e tjera të kërkuara, në përputhje me kriteret në fuqi për pajisjen me ekoetiketë.

4. Ministria, nëpërmjet sekretariatit, të ngritur sipas pikës 7 të këtij kreu, shqyrton dokumentacionin brenda 25 ditëve pune, nga data e marrjes së kërkesës.

5. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, ministria i kërkon operatorit plotësimin e tij, brenda 30 ditëve pune. Në qoftë se operatori nuk e plotëson dokumentacionin brenda afatit të caktuar, kërkesa nuk do të konsiderohet e paraqitur.

6. Sekretariati kryen funksionet administrative të komisionit, regjistron kërkesat e paraqitura dhe njofton kryetarin e komisionit. Kryetari thërret komisionin, duke përcaktuar datën dhe orën e takimit, jo më vonë se 40 ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

7. Personi/at përgjegjës, me funksionin e sekretariatit të komisionit, është/janë nëpunës të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe emërohet/n me urdhër të ministrit.

8. Komisioni funksionon si organizëm ndërinstitucional, me përfaqësues nga ministrinë, në nivel zëvendësministrash, nga institutet kërkimore-shkencore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, shoqatat mjedisore dhe grupet e interesit, dhe drejtohet nga zëvendësministri përgjegjës për mjedisin. Ngritja, përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit. Mënyra dhe vlera e pagesës së anëtarëve të Komisionit, të cilët nuk janë përfaqësues të ministrive apo institucioneve të varësisë së tyre, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit dhe përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për mjedisin.

9. Komisioni realizon procesin e verifikimit të studimit, në mënyrë të paanshme dhe të besueshme, për harmonizimin e produktit me kriteret, brenda 60 ditëve pune nga data e mbledhjes së komisionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës.

10. Operatori paguan një tarifë shërbimi për marrjen e ekoetiketës dhe një tarifë shërbimi vjetor, të cilat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të dhe ministrit të Financave. Të ardhurat nga këto tarifa derdhen në buxhetin e shtetit.

11. Nëse komisioni konstaton se produkti i plotëson kriteret e përcaktuara në udhëzim, referuar pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, për pajisjen me ekoetiketë, i propozon ministrit dhënien e ekoetiketës.

12. Ekoetiketa jepet për një periudhë jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet.

13. Nëse komisioni konstaton se produkti nuk i plotëson kriteret, ai propozon që studimi, i përmendur në shkronjën “c”, të pikës 2, të këtij kreu, të rishikohet dhe plotësohet brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh.

14. Komunikimi mes komisionit dhe operatorit realizohet nëpërmjet sekretariatit.

15. Operatori gëzon të drejtën e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale.

16. Format i ekoetiketës, logos, sipas produktit apo grupproduktit, numri i regjistrimit dhe mënyra e përdorimit të logos miratohen me udhëzim të ministrit.

17. Ministria krijon regjistrin e ekoetiketave të dhëna, duke vendosur numrin e regjistrimit për secilin produkt, që miratohet me urdhër të ministrit, dhe i publikon ato në faqen e saj elektronike.

18. Etiketimi përdoret vetëm për produktin që përputhet me kriteret e ekoetiketimit, të zbatueshme për produktin në fjalë dhe për të cilat është dhënë ekoetiketa.

19. Operatori përballon, me shpenzimet e veta, kostot e testimit dhe vlerësimit të konformitetit me kriteret e ekoetiketimit.

20. Kur kriteret e ekoetiketimit kërkojnë që fabrikat e prodhimit të përmbushin disa kërkesa, ato duhet të përmbushen nga të gjitha fabrikat në të cilat prodhohen produktet që mbajnë ekoetiketën.

21. Komisioni pranon rezultatet e kryerjes së testeve për produktet vetëm nga laboratorë të certifikuar dhe akredituar, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni mund të kërkojë kryerjen e testeve të tjera apo ritestim për produktet, kostot e të cilave përballohen nga operatori.

22. Operatori mund të vendosë ekoetiketën në produkt vetëm pas miratimit nga ministri. Operatori duhet të vendosë, gjithashtu, numrin e regjistrimit, në produktin që mban ekoetiketën, sipas formatit të referuar në pikën 16, më lart.

23. Komisioni, kryesisht ose nëpërmjet sekretariatit:

a) verifikon, periodikisht, përputhshmërinë e produktit me kriteret dhe kushtet e ekoetiketës, gjatë afatit të vlefshmërisë së saj;

b) njofton operatorin për çdo ankesë të bërë, në lidhje me produktin që mban ekoetiketën, duke ruajtur anonimin e ankuesit;

c) ka të drejtë të hyjë në ambientet në të cilat prodhohet ose ofrohet produkti.

24. Ministri, me propozim të komisionit, mund ta heqë ekoetiketën, kur operatori nuk vepron në përputhje me kriteret dhe kushtet, në bazë të të cilave është dhënë ekoetiketa ose nuk i përmbush më kriteret e përcaktuara për pajisjen me ekoetiketë.

25. Ekoetiketa nuk mund të përdoret si një markë tregtare apo pjesë e saj.

26. Ndalohet:

a) përdorimi i ekoetiketës apo i një logoje të ngjashme me të me qëllim keqinformimin e konsumatorëve;

b) mosrespektimi i kushteve dhe afatit të përcaktuar në ekoetiketë;

c) vazhdimi i përdorimit të ekoetiketës pasi është hequr nga ministri.

27. Prodhuesi, i cili është i pajisur me ekoetiketën “EU ecolabel”, sipas normativës së Bashkimit Evropian, nuk i nënshtrohet procedurave të këtij vendimi për pajisjen me ekoetiketë.

IV. KUNDËRVAJTJET DHE HYRJA NË FUQI

1. Mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas shkronjës “g”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

2. Udhëzimet e përbashkëta, të përmendura në pikën 4, kreu II, të këtij vendimi, miratohen brenda 5 viteve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Komi-sioni Shtetëror për Dhënien e Ekoetiketës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 3 (tre) muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 1

LISTA E PRODUKTEVE DHE GRUP PRODUKTEVE PËR TË CILAT MUND TË JEPET EKOETIKETA

1. Produkte të higjienës dhe përkujdesjes së pamjes (bukurisë)
 - sapunë, shampo, balsam flokësh
 - peceta higjienike thithëse (absorbuese)
2. Produkte të pastrimit
 - Pastrues sanitarë dhe pastrues për të gjitha qëllimet
 - Detergjentë për makinat larëse
 - Detergjentë për makina larëse automatike industriale dhe institucionale
 - Detergjentë për larje me dorë
 - Detergjentë për lavanderi
 - Detergjentë për lavanderi industriale dhe institucionale
3. Veshje dhe tekstile
 - Tekstile
 - Këpucë dhe të gjitha veshjet për këmbët
4. Produktet që vetëpërdoren (*Do it yourself*)
 - Lustrues (verniçe) dhe bojëra
5. Pajisje elektronike
 - Pajisjet e imazhit
 - Kompjuter personal (laptop)
 - Kompjuter të vegjël (notebook)
 - Televizor
6. Mbulesa
 - Veshje druri e dyshemesë (parkete)
 - Veshje

- Mbulesë tekstile e dyshemesë
- 7. Mobilje
 - Mobilje druri
- 8. Produkte kopshtarie
- 9. Pajisje shtëpiake
 - Burimet e dritës (llambat)
 - Pajisjet e nxehtësisë
 - Pajisjet ngrohëse me ujë
- 10. Lubrifikantë
- 11. Artikuj të tjerë shtëpiakë
 - Dyshek krevati
 - Pajisjet hidrosanitare
- 12. Produktet e letrës
 - Letër e konvertuar
 - Letër gazete
 - Letër e printuar
 - Letër kopjimi dhe grafike
 - Letër higjienike
- 13. Akomodim pushimesh
 - Shërbime kampingu
 - Shërbime për akomodimin e turistëve
- 14. Ndërtesat e zyrave
- 15. Shërbimet e pastrimit